



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

lidhur me vizitat në stacionet policore

Drejtuar: Z. Xhelal Sveçla, ministër në detyrë
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm
Policia e Kosovës

Kopje: Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 27 tetor 2025

Hyrje

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit në vijim: Mekanizmi) vizitoi stacionet policore, si në vijim:

- Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë;
- Stacionin Policor në Mitrovicë – Veri;
- Stacionin Policor në Zveçan;
- Stacionin Policor në Leposaviq;
- Stacionin Policor “Jugu” në Prishtinë;
- Stacionin Policor “Veriu” në Prishtinë;
- Stacionin Policor në Gjakovë;
- Stacionin Policor në Malishevë;
- Stacionin Policor në Rahovec;
- Stacionin Policor në Prizren.

Bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi ka mandat që, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të vizitojë të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social etj.

Andaj në këtë vit, Avokati i Popullit, përmes Mekanizmit realizoi vizita në dhjetë stacione policore.

Qëllimi i vizitave

Qëllimi i vizitave në stacionet e lartpërmendura policore u bë për të vlerësuar nëse janë respektuar të drejtat themelore të personave të arrestuar: e drejta për ta njoftuar anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për arsyen e arrestimit; e drejta për avokat mbrojtës; e drejta për shërbime mjekësore si dhe kushtet e akomodimit në qendrat e ndalimit policor. Këto të drejta janë të përcaktuara dhe të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me Mekanizmin gjatë vizitave

1. Gjatë vizitave në stacionet e lartpërmendura, Policia i ofroi Mekanizmit bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat në çdo stacion policor. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta realizuar detyrën, iu mundësua qasje në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi i personave të arrestuar, pa praninë e zyrtarëve policorë.

Garancitë kundër keqtrajtimit

2. Të drejtat e personave të arrestuar nga Policia janë të përcaktuara dhe të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale dhe me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në vijim: Komiteti Evropian), në Raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, theksoi rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia, të cilat janë: e drejta për ta njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën); e drejta për të pasur një avokat dhe e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku, sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).¹
4. Sipas Komitetit Evropian, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përcaktohet në kuadër të sistemit ligjor të një vendi.
5. Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës këto të drejta themelore të personave të arrestuar dhe në mbajtje nga autoritetet policore i parasheh edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.

Trajtimi

6. Mekanizmi realizoi intervista me disa persona që ishin në mbajtje në disa prej stacioneve policore të lartcekura, por nuk mori ankesa për sa i përket trajtimit ose mosrespektimit të të drejtave të tyre. Për më tepër, pati disa pohime nga të ndaluarit se ndaj tyre zyrtarët policorë patën trajtim profesional dhe shumë korrekt në qendrat e ndalimit. Po ashtu, të ndaluarit nuk pohuan se u janë mohuar të drejtat themelore, si: qasja në avokat, qasja në shërbime shëndetësore dhe njoftimi i familjes, të drejta të cilat janë të garantuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
7. Përveç kësaj, gjatë vizitave në stacionet policore të lartpërmendura, Mekanizmi shqyrtoi dokumentacionin relevant dhe vërejti se të gjitha stacionet policore e posedojnë dokumentin standard (dosjen e të arrestuarit/ndaluarit), në të cilin regjistrohen të gjitha të dhënat lidhur me të arrestuarin, në pajtim me nenin 170 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Kushtet fizike në këto stacione policore

8. Bazuar në Procedurat Standarde të Operimit, qendrat e ndalimit duhet të jenë në përputhshmëri me Rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (në vijim: Komiteti Evropian), duke u bazuar në Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore Jonjerëzore dhe Poshtëruese.²
9. Më 31 janar 2025, gjatë vizitës në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, Mekanizmi konstatoi se nuk janë bërë përmirësime në kushtet infrastrukturore dhe të punës, për shkak se ndërtimi i qendrës së re është ende në proces, varësisht nga kushtet atmosferike dhe dinamika e punimeve të kompanisë ndërtimore. Aktualisht funksionojnë vetëm dy qeli, ndërsa të tjerat janë jashtë përdorimit për shkak të rrjedhjeve të ujit nga tubacionet e ngrohjes. Në raste mbipopullimi, personat e ndaluar transferohen në qendrat e tjera të mbajtjes (në Drenas, Graçanicë, Podujevë dhe Lipjan). Trajnimet e brendshme zhvillohen rregullisht (40 orë të obligueshme). Më 10 shkurt u planifikua zhvillimi i një trajnimit për policët e rinj. Gjatë vizitës, Mekanizmi shqyrtoi dosjet e personave të ndaluar dhe

¹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f/>

² Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit për Qendrat e Ndalimit, DDO-04/0121/2016, pika 1.6, faqe 4.

konstatoi se ata informohen për të drejtat e tyre dhe kanë qasje në shërbime mjekësore, përfshirë ndihmën e shpejtë dhe transportin për në spital me përcjellje policore në raste urgjente. Megjithatë, u evidentuan mungesa të materialeve higjienike, si dhe probleme me furnizimin e stafit me uniforma dhe çizme – përjashtim bën vetëm gjenerata e re e stafit, e cila u furnizua në mënyrë të rregullt me veshmbathje. Më 8 korrik 2025, gjatë një vizite tjetër në këtë qendër, ekipi i Mekanizmit pa nga afër se ndërtimi i qendrës së re ishte afër përfundimit.

10. Më 13 mars 2025, Mekanizmi realizoi një vizitë në Stacionin Policor në Mitrovicë – Veri. Gjatë takimit, komandanti informoi se aktualisht po zhvillohen punime infrastrukturore në stacionet policore të Zveçanit dhe të Leposaviqit, ndërsa së shpejti pritet të fillojnë punimet edhe në Stacionin Policor në Veri të Mitrovicës. Qëllimi i vizitës ishte të njoftoheshin me planifikimet dhe zhvillimet e rinovimeve në proces, si dhe të bëhej një vlerësim i përgjithshëm i kushteve ekzistuese përpara përfundimit të punimeve. Në takimin e realizuar në Stacionin Policor në Mitrovicë - Veri morën pjesë edhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, OSBE-ja dhe Policia, ku u diskutuan edhe çështje të tjera që ndërlidhen me punën e institucioneve.
11. Më 13 mars 2025, Mekanizmi realizoi një vizitë në Stacionin Policor në Zveçan. Gjatë vizitës u konstatua se punimet e renovimit ishin në fazën përfundimtare. Qendra e ndalimit përbëhej nga tri dhoma – dy dhoma me nga dy shtretër dhe një dhomë me një shtrat – të gjitha me ndriçim natyral dhe ventilim të mjaftueshëm. Dhomat ishin të pajisura me dyshekë dhe batanije të reja, ndërsa sistemi i kamerave ishte funksional dhe sigurohej respektimi i privatësisë së personave të ndaluar.
12. Më 13 mars 2025, Mekanizmi realizoi një vizitë në Stacionin Policor në Leposaviq. Gjatë vizitës u konstatua se punimet e renovimit ishin në fazën përfundimtare. Qendra e ndalimit përbëhej nga katër dhoma – dy dhoma me nga dy shtretër dhe dy dhoma me nga një shtrat – të gjitha me ndriçim natyral dhe ventilim të mjaftueshëm. Dhomat ishin të pajisura me dyshekë dhe batanije të reja, ndërsa sistemi i kamerave ishte funksional, duke siguruar mbikëqyrje dhe respektim të privatësisë së personave të ndaluar.
13. Më 14 mars 2025, Mekanizmi realizoi një vizitë në Stacionin Policor “Jugu” në Prishtinë, i cili është ndër stacionet me numrin më të lartë të pranimeve në rajon, me rreth 5 000 – 6 000 raste në vit. Stacioni nuk posedon qendër të mbajtjes, prandaj personat e arrestuar qëndrojnë aty për një periudhë deri në gjashtë orë, pas së cilës transferohen në qendrat përkatëse të mbajtjes. Intervistimet me të arrestuarit zhvillohen në zyrat e hetimeve. Sipas Kapitenit të Stacionit Policor “Jugu”, nga personat e ndaluar nuk morën asnjë ankesë për keqtrajtim dhe aktualisht asnjë zyrtar policor nuk është nën hetim lidhur me këtë çështje nga Inspektorati Policor i Kosovës. Departamenti i Hetimeve vepron në mënyrë të pavarur nga komandanti i stacionit dhe raporton drejtpërdrejt te shefi i vet. Kamerat e sigurisë u instaluan në disa dhoma, veçanërisht në dhomën e dedikuar për rastet e dhunës në familje. Edhe pse u realizuan disa rinovime, nevojiten përmirësime të mëtejshme. Problemi i ngrohjes, i evidentuar në të kaluarën, u zgjidh pas lidhjes me sistemin qendror të ngrohjes “Termokos”. Furnizimi me materiale të përgjithshme ishte i kënaqshëm; megjithatë, u evidentuan mungesa të mëdha për printerë dhe automjete, gjë që e vështirëson procesin e punës. Shefi i Hetimeve informoi se më 1 janar 2024 sektori i hetimeve u riorganizua dhe aktualisht përfshin 127 zyrtarë të shpërndarë në tri njësi: “Jug”, “Qendër” dhe “Veri”. Mungesa e hapësirës adekuate dhe ndarja në njësi të

ndryshme vështirësojnë punën. Aktualisht, njësia “Jug” ka 46 hetues, njësia “Qendër” 36, ndërsa njësia “Veri” 23 hetues. Është bërë kërkesë për rritje të stafit, veçanërisht për shkak të shtimit të rasteve të dhunës në familje – 29 raste në “Jug” dhe 20 raste në “Qendër” vetëm gjatë periudhës janar–mars 2025. Janë vendosur për herë të parë hallka elektronike për viktimën dhe dhunuesin, por pajisjet kishin probleme teknike (zhurmë gjatë funksionimit). Për sa u përket kushteve të punës, Mekanizmi vërejti se gjashtë hetues ndajnë të njëjtën zyrë dhe kanë në dispozicion vetëm dy kompjuterë, nga të cilët një është jashtë funksioni. Dhoma e intervistimit është e pajisur me kamera, por jo e përshtatshme. Dhoma miqësore ishte në gjendje të mirë, falë donacionit të Bashkimit Evropian. Megjithatë, problemet kryesore mbeten mungesa e automjeteve, e materialeve higjienike dhe e uniformave, të cilat nuk janë shpërndarë që nga viti 2017. Stafi mbulon vetë shpenzimet për rrobat civile dhe siç raportoi ai, nuk kompensohet për pagën e 13-të, as për punën gjatë fundjavave dhe as për shërbimet gjatë orëve të natës.

14. Më 3 prill 2025, Mekanizmi realizoi një vizitë në Stacionin Policor “Veriu” në Prishtinë, ku u takua me komandantin dhe zëvendëskomandanten e stacionit, të cilëve u komunikua qëllimi i vizitës. Stacioni “Veriu” mbulon një territor prej 532 km², që përbën rreth një të tretën e sipërfaqes së Prishtinës, dhe aktualisht funksionon në një objekt të komunës në lagjen Arbëria, ku është vendosur përkohësisht. Ai nuk posedon qendër mbajtjeje; të arrestuarit qëndrojnë deri në 6 orë dhe intervistohen në zyrat e stafit policor. Stafi i stacionit përbëhet nga 159 zyrtarë policorë, përfshirë 25 gra dhe 4 zyrtarë nga komunitetet joshumicë (3 serbë dhe 1 rom). Departamenti i Hetimeve funksionon në mënyrë të pavarur dhe nuk i përgjigjet komandantit të stacionit. Stacioni është i furnizuar mirë me material të punës, megjithatë problemet me printerët po ndikojnë në efikasitetin e tij. Po ashtu, është evidentuar nevoja për më shumë mjete transporti për shkak të mbulueshmërisë së madhe territoriale. Trajnimet për stafin zhvillohen rregullisht në Akademinë e Policisë.
15. Më 14 prill 2025, ekipi i Mekanizmit vizitoi Stacionin Policor në Gjakovë, duke filluar me qendrat e mbajtjes. Nga gjashtë dhoma ndalimi, vetëm tri ishin funksionale dhe të pajisura me kamera aktive. Ventilimi i ri u funksionalizua një muaj më parë, por higjiena nuk ishte në nivelin e duhur. Gjatë vizitës, ekipi intervistoi dy persona të ndaluar, të cilët deklaruan se u trajtuan mirë që nga momenti i arrestimit dhe nuk patën ankese. Kapiteni i stacionit informoi se objekti u ndërtua në vitin 2007 dhe nuk pati asnjë renovim, pavarësisht kërkesave të përsëritura. Nuk u raportuan raste keqtrajtimi, dhe stacioni disponon një dhomë miqësore për të ndaluarit. Stacioni posedon një dhomë miqësore, ka mjaftueshëm automjete, por defektet e shpeshta pengojnë kryerjen e detyrave. Gjithashtu, u evidentuan vështirësi të vazhdueshme me pajisjet për fotokopjim dhe printim, gjë që ndikon në efikasitetin e punës.
16. Më 26 maj 2025, Mekanizmi vizitoi Stacionin Policor në Malishevë dhe konstatoi se gjendja aty mbetet e njëjtë si në vitet e kaluara, pasi nuk u ndërmor asnjë veprim për funksionalizimin e Qendrës së Ndalimit. Stacioni ka pesë dhoma ndalimi, por asnjëra prej tyre nuk është funksionale tash e disa vite, për shkak të dëmtimit të kamerave dhe kushteve të papërshtatshme. Mosfunksionimi i Qendrës paraqet një sfidë serioze, pasi të gjithë të ndaluarit duhet të transportohen në qendrat e tjera të stacioneve, gjë që rrit kohën e punës së stafit, shkakton ngecje në kryerjen e detyrave dhe shton kërkesat logjistike dhe kostot operative për automjetet. Stacioni Policor i Malishevës ka në dispozicion gjithashtu

një Dhomë Mike, e financuar nga komuna, që ofron kushte të përshtatshme për intervistim dhe qëndrim të fëmijëve.

17. Më 26 maj 2025, Mekanizmi vizitoi Stacionin Policor në Rahovec, i cili ka tri dhoma ndalimi me nga dy shtretër secila, të pajisura me kamera vëzhgimi. Ekipi u informua se situata e mungesës së automjeteve është përmirësuar; stacioni posedon katër vetura, të cilat megjithatë nuk janë të mjaftueshme për nevojat operationale. Po ashtu, vazhdon mungesa e uniformave për zyrtarët policorë dhe problemi me pajisjet për fotokopjim. Dhomat Mike është e rregulluar mirë dhe e përshtatshme për intervistim dhe qëndrim të fëmijëve. Ekipi i Mekanizmit u informua gjithashtu se të ndaluarit nga Malisheva dhe disa nga Gjakova transportohen në Qendrën e Ndalimit në Rahovec, gjë që shkakton një numër të madh të të ndaluarve dhe sfidë për zyrtarët policorë në menaxhimin dhe kryerjen e detyrave. Rreshteri dhe zyrtarë të tjerë policorë informuan se u nda buxheti për rinovimin e Stacionit Policor në Rahovec, përfshirë Qendrën e Ndalimit. Në kuadër të këtij projekti, stacioni do të pajiset me lift, shkallë emergjente dhe parking për stacionin.
18. Më 28 maj 2025, Mekanizmi realizoi një vizitë në Stacionin Policor të Prizrenit, ku u takua fillimisht me zyrtarin përgjegjës të ndërrimit, i cili informoi ekipin për funksionimin e përgjithshëm të Qendrës së Ndalimit. Qendra posedon pesë dhoma ndalimi dhe operon me staf prej gjashtë zyrtarësh, përfshirë një femër. Stafi konsiderohet i pamjaftueshëm, pasi në disa ndërrime shërben vetëm një zyrtar. Kushtet e përgjithshme në Qendër ishin të mira: ventilim funksional, dyshekë të rinj dhe me rezerva të mjaftueshme, ushqimi ofrohet tri herë në ditë nga Qendra e Paraburgimit në Prizren, kamerat janë aktive dhe stafi posedon pajisje e uniforma të mjaftueshme. Megjithatë, u evidentuan disa sfida. Më e theksuara është mungesa e banjave brenda dhomave të ndalimit, pasi aktualisht ekziston vetëm një banjë e përbashkët në korridor, gjë që e vështirëson menaxhimin për shkak të mungesës së stafit. Është kërkuar që, ngjashëm me qendrat e tjera, të integrohen banjat brenda dhomave të ndalimit. Gjithashtu, u raportua se pajisja për fotokopjim është jofunksionale tash pesë muaj, dhe, për pasojë, stafi detyrohet të bëjë kopje në drejtorinë policore ose në biznese private, me pagesë. Gjatë vizitës, Mekanizmi zhvilloi intervista me dy persona të ndaluar, të cilët konfirmuan se janë trajtuar mirë dhe nuk patën ankesa në lidhje me trajtimin nga policia.
19. Për sa u përket materialeve informuese (broshurave) që ilustrojnë të drejtat e njeriut, në disa nga qendrat e ndalimit të përmendura ato ishin të vendosura në mure, ndërsa në disa të tjera mungonin. Zyrtarët policorë sqaruan se broshurat për të drejtat e personave të ndaluar vendosen rregullisht, por shpesh hiqen ose dëmtohen nga vetë të ndaluarit.
20. Gjithashtu, ashtu si edhe në vitet e kaluara, edhe gjatë vizitave të këtij viti në stacionet e lartpërmendura, Mekanizmi u njoftua se sfidën më të madhe për zyrtarët policorë e paraqesin personat përdorues të substancave narkotike dhe ata me probleme të shëndetit mendor. Këto kategori konsiderohen veçanërisht të vështira për t'u menaxhuar, pasi kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme për 48 orë për shkak të rrezikut të vetëlëndimit ose vetëvrasjes. Sipas zyrtarëve policorë, këta persona paraqesin rrezik si për veten, ashtu edhe për stafin policor, duke qenë se stafi nuk ka trajnim të specializuar për trajtimin dhe menaxhimin e këtyre kategorive të të ndaluarve.
21. Po ashtu, në të gjitha stacionet e lartpërmendura, Mekanizmi pranoi ankesa nga zyrtarët policorë, lidhur me kushtet e tyre të punës. Ndër çështjet më të theksuara janë: stazhi i

beneficiar, sëmundjet kronike të zyrtarëve, mungesa e shujtës dhe kushtet e përgjithshme të punës.

Kujdesi shëndetësor

22. Për sa u përket shërbimeve mjekësore, si një e drejtë themelore e personave të arrestuar nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike shëndetësore, si Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Qendra Klinike Universitare (QKU), varësisht nga nevojat për trajtim. Lidhur me këtë të drejtë, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës (në vijim: Mekanizmi) nuk mori ankesa nga personat e intervistuar. Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar u vërejt se policia evidentoi në dosjet personale të të ndaluarve njoftimin për të drejtën për të përfituar shërbime mjekësore, si dhe rastet kur u është ofruar ndihma mjekësore.
23. Për më tepër, Mekanizmi vëren një praktikë pozitive në shumicën e stacioneve policore, ku personat e arrestuar, përfshirë të miturit dhe të rriturit, para se të dërgohen në ndalim, dërgohen për kontrolle mjekësore në qendrën më të afërt të mjekësisë familjare.

Ushqimi

24. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton se, në rastet kur personi i privuar nga liria mbahet më shumë se 12 orë, atij duhet t'i sigurohen tri racione ushqimore në ditë. Personave të arrestuar që dërgohen në mbajtje, u ofrohen tri racione ushqimore brenda 24 orëve, në përputhje me kontratën e Policisë me kompaninë kontraktuese. Megjithatë, për sa i përket ushqimit në shumicën e stacioneve policore të lartcekura, Mekanizmi u informua nga zyrtarët policorë se personat e arrestuar shprehën shqetësime lidhur me cilësinë e ulët dhe sasinë e pamjaftueshme të ushqimit që u ofrohet, sipas kontratës përkatëse.

Parashtrimi i ankesave nga personat e arrestuar

25. Lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, personat e arrestuar kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa në stacionin policor ku mbahen, në Inspektoratin Policor të Kosovës, si dhe tek organet e jashtme monitoruese, siç janë Mekanizmi dhe organizatat joqeveritare, të cilave u lejohet të kryejnë vizita në vendet e privimit nga liria. Me qëllim të ofrimit të qasjes më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe mundësimin të parashtrimit konfidencial të ankesave, Avokati i Popullit vendosi kuti të ankesave në stacionet policore ku ekzistojnë qeli për mbajtjen e personave të arrestuar. Këto kuti hapen vetëm nga personeli i autorizuar i Avokatit të Popullit. Vlen të theksohet se, ndonëse këto kuti u hapën nga zyrtarët rajonalë të Avokatit të Popullit, deri më tani nuk u gjet asnjë ankesë e depozituar nga personat e ndaluar.

Kujdesi i shëndetit mendor i Policisë së Kosovës

26. Policia e Kosovës ka një rol kyç në garantimin e sigurisë publike, si dhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Këto përgjegjësi shpesh e ekspozojnë personelin policor ndaj situatave me ngarkesë të lartë emocionale, traumave dhe stresit kronik. Në këtë kontekst, mbështetja psikologjike për zyrtarët policorë, si dhe për qytetarët që marrin shërbime nga Policia, përbën një element thelbësor të profesionalizmit dhe efektivitetit të institucionit.

27. Mekanizmi vërejtë se në Policinë e Kosovës funksionon Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore, e cila është pjesë e Divizionit për Personel dhe Administrim brenda Departamentit për Burime Njerëzore. Sipas informatave të pranuar, në këtë drejtori janë të angazhuar tre psikologë klinikë, si dhe specialistë të oftalmologjisë dhe epidemiologjisë, të cilët fillimisht u pranuan si mjekë të përgjithshëm dhe më pas u specializuan në fusha të caktuara. Mekanizmi konstatoi se aktualisht nuk ka specialist të Mjekësisë Familjare apo mjek psikiatër, ndërsa numri i psikologëve klinikë është shumë i kufizuar. Gjithashtu, mungojnë kushtet e përshtatshme për punën e psikologëve, pasi ata nuk kanë hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për zhvillimin e seancave psikologjike. Mekanizmi vlerëson se rritja e numrit të psikologëve do të kontribuonte ndjeshëm në përmirësimin e mirëqenies së personelit policor, duke marrë parasysh se puna policore shpesh shoqërohet me ngjarje traumatike dhe situata kërcënuese për jetën. Mungesa e mbështetjes psikologjike mund të rrisë rrezikun për çrregullime si stresi post-traumatik (PTSD), depresioni, ankthi dhe djegia profesionale. Në këtë drejtim, psikologët do të mund të ofronin ndihmë të specializuar, përfshirë seanca terapie dhe trajnime për menaxhimin e stresit. Po ashtu, angazhimi i tyre në proceset hetimore dhe operationale do të përmirësonte cilësinë e hetimeve dhe do të reduktonte mundësinë e gabimeve procedurale.
28. Mekanizmi konstaton se rritja e numrit të psikologëve klinikë, përfshirë vendosjen e tyre në secilin rajon, do të sillte përfitime të konsiderueshme për Policinë e Kosovës. Kjo do të ndihmonte në parandalimin e abuzimeve dhe përdorimit të tepruar të forcës, përmirësimin e gatishmërisë për përballje me situata emergjente dhe ngjarje traumatike masive, si dhe në uljen e mungesave në punë që rezultojnë nga problemet e shëndetit mendor.

Konstatimet e Avokatit të Popullit lidhur me kushtet e punës së policisë

29. Avokati i Popullit vëren se në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë nuk u realizua furnizimi me uniforma të reja për zyrtarët policorë, ndërsa furnizimi me materiale higjienike vazhdon të jetë i pamjaftueshëm.
30. Avokati i Popullit konstaton se në Stacionin Policor “Jugu” në Prishtinë nuk u bë furnizimi me uniforma të reja për zyrtarët policorë, furnizimi me materiale higjienike vazhdon të jetë i pamjaftueshëm. Ka mungesë dhe defekte të vazhdueshme në sistemin e fotokopjeve dhe gjithashtu ka mungesë të pajisjeve të IT (PC). Personat e arrestuar që mbahen deri në 6 orë në këtë stacion intervistohen dhe qëndrojnë në zyrën e hetimeve, për shkak të mungesës së hapësirave të dedikuara për qëndrim afatshkurtër.
31. Avokati i Popullit konstaton se në Stacionin Policor “Veriu” në Prishtinë mungon furnizimi i rregullt me tonerë për printerë, si dhe servisimi i rregullt i pajisjeve. Personat e arrestuar që mbahen deri në 6 orë në këtë stacion qëndrojnë në zyrat e stafit policor, për shkak të mungesës së hapësirave të dedikuara për qëndrim afatshkurtër. Po ashtu, ka mungesë të mjeteve të transportit, për shkak të mbulueshmërisë së madhe territoriale të stacionit në fjalë.
32. Avokati i Popullit konstaton se në Stacionin Policor në Gjakovë, nga gjashtë dhoma ndalimi, vetëm tri janë funksionale dhe të pajisura me kamera aktive. Higjiena në këto hapësira nuk është në nivel të kënaqshëm, ndërsa në objektin e ndërtuar në vitin 2007 nuk pati asnjë renovim, pavarësisht kërkesave të përsëritura. Mjetet e transportit janë të mjaftueshme, por defektet e shpeshta në vetura paraqesin pengesë për kryerjen e detyrave

zyrtare. Po ashtu, u evidentuan vështirësi të vazhdueshme me pajisjet për fotokopjim dhe printim, gjë që ndikon në efikasitetin e punës.

33. Avokati i Popullit konstaton se në Stacionin Policor në Malishevë, asnjëra nga pesë dhomat e ndalimit nuk është funksionale, për shkak të dëmtimit të kamerave dhe kushteve të papërshtatshme për qëndrim.
34. Avokati i Popullit konstaton se në Stacionin Policor në Rahovec mungon furnizimi me uniforma për zyrtarët policorë, ndërsa numri i veturave është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat operationale. Gjithashtu, mosfunksionimi i pajisjeve për fotokopjim ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e punës.
35. Avokati i Popullit konstaton se në Stacionin Policor të Prizrenit, në dhomat e ndalimit mungojnë banjat, ndërsa pajisja për fotokopjim është jofunksionale që pesë muaj.
36. Avokati i Popullit konstaton se zyrtarët policorë në stacionet policore të lartcekura problemin më të madh e kanë me personat që janë përdorues të substancave narkotike dhe me personat me probleme të shëndetit mendor. Këto kategori po ua vështirësojnë shumë punën, pasi janë vështirë të menaxhueshëm dhe duhet të vëzhgohen pandërprerë për 48 orë, nga frika e tentimit për vetëlëndim/vetëvrasje. Këta persona po paraqesin rrezik për veten dhe për stafin policor, pasi stafi nuk është i trajnuar për t'i trajtuar këto kategori të të ndaluarve.
37. Avokati i Popullit konstaton se në të gjitha stacionet policore mori shqetësime dhe vërejtje se kushtet e punës të zyrtarëve policorë, në shumicën e stacioneve të lartcekura, janë të pafavorshme për punë, pasi ka mungesë të inventarit, të printerëve, të mjeteve higjienike dhe të veturave.
38. Avokati i Popullit konstaton se rritja e numrit të psikologëve klinikë, përfshirë vendosjen e tyre në secilin rajon, do të sillte përfitime të konsiderueshme për Policinë e Kosovës. Kjo do të ndihmonte në parandalimin e abuzimeve dhe përdorimit të tepruar të forcës, përmirësimin e gatishmërisë për përballje me situata emergjente dhe ngjarje traumatike masive, në menaxhimin e stresit etj.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitave në stacionet policore të lartcekura, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministritë së Punëve të Brendshme:

1. Të sigurohet furnizim i rregullt dhe i mjaftueshëm me uniforma për të gjithë zyrtarët policorë.
2. Të garantohet furnizim i rregullt dhe i mjaftueshëm me materiale higjienike dhe të përmirësohen kushtet e higjienës.
3. Të pajisen me pajisje funksionale për fotokopjim dhe printim, të kenë furnizim të mjaftueshëm me tonerë dhe materiale përkatëse, si dhe të sigurohet mirëmbajtja e rregullt teknike e këtyre pajisjeve.
4. Të mbahen trajnime adekuate për stafin policor për trajtimin e personave të ndaluar me sëmundje mendore.

5. Në të gjitha dhomat/qelitë në qendrat e ndalimit të vendosen në mure kartat për njoftimin për të drejtat e personave të ndaluar.
6. Të bëhet furnizimi me pajisje bazike IT (PC) në Stacionin Policor “Jugu” – Prishtinë.
7. Të krijohen hapësira të dedikuara për qëndrimin afatshkurtër të personave të ndaluar, për të shmangur qëndrimin në hapësira pune në Stacionin Policor “Jugu” – Prishtinë.
8. Të krijohen hapësira të dedikuara për qëndrimin afatshkurtër të personave të ndaluar, për të shmangur qëndrimin në hapësira pune në Stacionin Policor “Veriu” – Prishtinë.
9. Të rritet numri i mjeteve të transportit për të përmbushur nevojat operative të Stacionit Policor “Veriu” – Prishtinë.
10. Të bëhet funksionalizimi i të gjitha dhomave të ndalimit dhe të sigurohen kamera funksionale në të gjitha hapësirat e Qendrës së Ndalimit në Stacionin Policor të Gjakovës.
11. Të ndërmerren veprime për renovime në objektin ekzistues për të përmirësuar kushtet e punës në Stacionin Policor të Gjakovës.
12. Të sigurohet mirëmbajtja e rregullt e automjeteve të Stacionit Policor të Gjakovës, për të shmangur defektet.
13. Avokati i Popullit ripërsërit rekomandimin që të mënjanoen problemet dhe të funksionalizohet Qendra e Ndalimit në Stacionin Policor në Malishevë.
14. Të rritet numri i mjeteve të transportit për të përmbushur nevojat operative të Stacionit Policor të Rahovecit.
15. Të rritet numri i stafit policor në Stacionin Policor të Prizrenit, për të mbuluar ndërrimet e punës në mënyrë adekuate.
16. Në Stacionin Policor të Prizrenit të sigurohet ndërtimi i banjave brenda dhomave të ndalimit, në përputhje me standardet për trajtimin e personave të privuar nga liria.
17. Të rritet numri i psikologëve klinikë, pra të ketë shërbime psikologjike në çdo regjion të Kosovës duke u mundësuar edhe kushtet për kryerjen e detyrave profesionale.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit